



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARRIV ARRIV ARRIV ARCHIVE		
Nr. Prot Broj. prot. Prot. no	Nr. i faq. Br. str. No. page.	Data: Datum: Date
152	5	02.03.2026
PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA		

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës  
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (OIK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, nenit 17, paragrafi 4, nenit 18, paragrafi 2 të Statutit të OIK dhe nenit 58 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OIK, në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2026, miraton këtë:

## RREGULLORE ZGJEDHORE

### PËR VËZHguesIT E ZGJEDHJEVE

#### Neni 1

#### Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton procedurën për aplikim, shqyrtimin e aplikacioneve dhe akreditimin e organizatave vëzhguese, vëzhguesve të kandidatëve dhe mediave, si dhe të drejtat dhe detyrat e organizatave vëzhguese të akredituara dhe vëzhguesve të tyre.

#### Neni 2

#### Përkufizimet dhe shkurtesat

Për qëllim të kësaj Rregulloreje, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura kanë këtë kuptim:

1. **OIK** – Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të Tjerë Shëndetësorë të Kosovës.
2. **KQZ** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i OIK-ut.
3. **SKQZ** – Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. **KNJZ** – Komisioni i Njesisë Zgjedhore.
5. **VV (Vendvotimi)** – hapësira e përcaktuar për ushtrimin e të drejtës së votës.
6. **Vëzhgues** – person i akredituar nga KQZ për monitorimin e procesit zgjedhor.
7. **Vëzhgues i kandidatit** – person i propozuar nga kandidati i certifikuar dhe i akredituar nga KQZ.
8. **Organizatë vëzhguese** – organizatë joqeveritare, qeveritare, ndërqeveritare ose organizatë ndërkombëtare e specializuar në zgjedhje, të drejta të njeriut ose çështje shëndetësore.

9. **Media** – subjekt i regjistruar që ushtron veprimtari mediatike dhe akreditohet për vëzhgimin e procesit zgjedhor.
10. **Akreditim** – procedura përmes së cilës KQZ jep autorizim zyrtar për vëzhgimin e zgjedhjeve.
11. **Libri i Votimit** – material zgjedhor ku shënohen vërejtjet dhe ngjarjet gjatë procesit zgjedhor.

### **Neni 3**

#### **Akreditimi i organizatave dhe i vëzhguesve të tyre**

1. Kandidatët e certifikuar, organizatat joqeveritare (OJQ), organizatat ndërkombëtare të specializuara që merren me zgjedhjet, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe çështjet shëndetësore, si dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të aplikojnë për akreditim të vëzhguesve për zgjedhje.
2. Kërkesën për akreditim të vëzhguesve, çdo kandidat i certifikuar, çdo organizatë joqeveritare, qeveritare, ndërqeveritare, organizatë ndërkombëtare apo medium, mund ta parashtojë në KQZ brenda afatit kohor të përcaktuar nga KQZ.

### **Neni 4**

#### **Aplikimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve**

1. Subjektet e autorizuar për aplikim për vëzhgues duhet të plotësojnë dokumentacionin si në vijim:
  - 1.1. Formularin e akreditimit të organizatës vëzhguese – të miratuar nga KQZ;
  - 1.2. Listën e vëzhguesve, e cila përmban:
    - 1.2.1. emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal dhe numrin e telefonit për kontaktim për secilin vëzhgues, në formë fizike dhe elektronike.
2. Sekretariati i KQZ-së verifikon dokumentet e dorëzuara dhe, në rast nevojë, dërgon shkresë për korrigjim të dokumentacionit brenda pesë (5) ditëve për kandidatët.
3. Organizatat që kanë aplikuar për akreditim dhe kanë pranuar shkresë për korrigjim të dokumentacionit duhet t'i bëjnë korrigjimet dhe t'i ri-dorëzojnë dokumentet brenda afatit të përcaktuar nga Sekretariati.
4. KQZ miraton ose refuzon kërkesat e akreditimit:
  - 4.1. jo më vonë se pesë (5) ditë nga parashtrimi i kërkesës;
  - 4.2. në rast refuzimi, KQZ përmes Sekretariatit njofton me shkrim organizatën dhe e informon për të drejtën e kundërshtimit dhe ankimimit në KQZ dhe Gjyqin e Nderit, në afat jo më pak se 24 orë.
5. Sekretariati njofton organizatën për akreditimin dhe e pajis me vendim akreditimi dhe karta identifikuese për vëzhguesit.
6. Pranimi i kartave të identitetit bëhet nga përfaqësuesi i autorizuar i organizatës, i cili nënshkruan listën e pranim-dorëzimit.
7. Pranimi i kartelave të identitetit për vëzhguesit e kandidatëve bëhet ditën e zgjedhjeve nga Kryesuesi i Njësisë Zgjedhore.

## Neni 5

### Të drejtat dhe detyrat e organizatave të akredituara dhe të vëzhguesve të tyre

#### 1. Vëzhguesi ka të drejtë të:

- 1.1. jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës, nga hapja dhe mbyllja e vendvotimit e deri në përfundimin e numërimit të votave në KNJZ;
- 1.2. vëzhgojë çdo veprim të komisionerëve dhe të vrojtojë mënyrën e punës në vendvotim;
- 1.3. vëzhgojë mënyrën e identifikimit të votuesve nga Lista e Votuesve;
- 1.4. mbajë shënime lidhur me ecurinë e procesit në vendvotim;
- 1.5. jetë i pranishëm gjatë plotësimit të procesverbalit të vendvotimit;
- 1.6. paraqesë vërejtjet e tij në Librin e Votimit;
- 1.7. vëzhgojë, pa u penguar, përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve, përfshirë takimet pas ditës së zgjedhjeve, dëgjimet dhe aktivitetet lidhur me zgjedhjet, ankesat dhe parashtrirat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve dhe përcaktimin e kandidatëve fitues;
- 1.8. parashtrijë komente me shkrim komisioneve zgjedhore dhe këshillave të vendvotimeve;
- 1.9. vëzhgojë paketimin, transferimin, dorëzimin, trajtimin, numërimin, ruajtjen e sigurt dhe asgjësimin e fletëvotimeve;
- 1.10. pajiset me kopje të vendimeve, protokolleve, tabelave, procesverbaleve dhe dokumentacionit tjetër gjatë gjithë procesit zgjedhor, përfshirë proceset para dhe pas ditës së zgjedhjeve.

2. Në rast se vëzhguesi i kandidatit nuk ka shënuar vërejtjen e tij në Librin e Votimit, kandidati në ankesën e tij nuk mund ta bazojë pretendimin në dëshmitë e vëzhguesit i cili ka qenë i akredituar sipas propozimit të tij.

#### 3. Vëzhguesi ka për detyrë të:

- 3.1. respektojë kërkesat e kësaj rregulloreje dhe rregullat e KQZ-së;
  - 3.2. gjatë procesit zgjedhor të mos realizojë çfarëdo komunikimi me votuesit;
  - 3.3. mbajë distinktivin e identitetit të vëzhguesit në mënyrë të dukshme gjatë ushtrimit të aktiviteteve të vëzhgimit;
  - 3.4. përmbahet nga bartja e shenjave dalluese që shërbejnë si mjete propaganduese ose që mund të ndikojnë në vullnetin e votuesit apo ta identifikojnë atë me një subjekt politik ose kandidat të caktuar;
  - 3.5. përmbahet nga shkelja e të drejtës së votuesit për fshehtësinë e fletëvotimit dhe nga pengimi i procesit të votimit dhe administrimit të zgjedhjeve.
4. Një organizatë e akredituar vëzhguese mund të dërgojë një vëzhgues në takimet e KQZ-së dhe KNJZ-së.
  5. Organizata e akredituar apo kandidati propozues i vëzhguesit është përgjegjës dhe duhet të sigurojë që vëzhguesit e saj janë plotësisht të informuar për të drejtat dhe obligimet, si dhe për procesin zgjedhor.
  6. Organizata e akredituar dhe kandidati propozues janë përgjegjës për sjelljen individuale të vëzhguesve të tyre.
  7. Nëse organizata e akredituar ose kandidati propozues konstaton se ndonjëri nga vëzhguesit e tij ka shkelur kodin e sjelljes për vëzhgues, ajo duhet t'ia tërheqë distinktivin vëzhguesit dhe ta dorëzojë atë në KQZ për anulimin e akreditimit.
  8. Në çdo rast kur ndonjë komisioner vëren se vëzhguesi nuk i përmbahet rregullave të vendvotimit, vërejtja shënohet në Librin e Votimit dhe për këtë njoftohet kryesuesi i vendvotimit. Kryesuesi duhet t'ia tërheqë vërejtjen vëzhguesit dhe, në rast të përsëritjes, të kërkojë largimin e tij nga vendvotimi.
  9. KQZ, në çdo kohë, mund ta anulojë akreditimin e vëzhguesit që cenon rregullat zgjedhore, urdhrat apo procedurat administrative që lidhen me procesin zgjedhor.

## Neni 6

### Roli i vëzhguesve gjatë zgjedhjeve

1. Vëzhguesit mund të vëzhgojnë procesin e hapjes së vendvotimit, votimin, numërimin, paketimin dhe dorëzimin e materialeve nga vendvotimi te Njësitë Zgjedhore, me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi.
2. Jo më shumë se një vëzhgues nga e njëjta organizatë e akredituar apo nga i njëjti kandidat propozues mund të jetë i pranishëm në të njëjtin vendvotim gjatë proceseve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

## Neni 7

### Vëzhgimi i procesit të numërimit të fletëvotimeve në vendvotim nga mediat e akredituara

1. Numërimi i fletëvotimeve në vendvotim mund të vëzhgohet nga mediat e akredituara, të cilat lejohen të filmojnë dhe fotoqojnë.
2. Akreditimi i mediave bëhet përshtatshëm sipas procedurës së akreditimit të organizatave vëzhguese, ndërsa afatet mund të përcaktohen ndryshe nga KQZ.
3. Varësisht nga hapësira e vendvotimit, kryesuesi i vendvotimit cakton numrin e mediave që mund të përcjellin procesin e numërimit.
4. Përfaqësuesi i medias së akredituar duhet të paraqesë kërkesë pranë kryesuesit të vendvotimit për vëzhgimin e procesit të numërimit, para fillimit të këtij procesi. Kryesuesi e regjistron kërkesën në Librin e Votimit duke shënuar të dhënat e përfaqësuesit të medias.
5. Kryesuesi i vendvotimit i njofton mediat se mund të filmojnë procesin e numërimit të fletëvotimeve, pa paraqitur të dhëna personale të mbrojtura me ligj.
6. Përfaqësuesit e mediave qëndrojnë në vendin e caktuar nga kryesuesi, në largësi të përshtatshme nga tavolinat e punës dhe nuk lejohen të kenë kontakt fizik me materialet zgjedhore, të pengojnë procesin e numërimit apo të komunikojnë me anëtarët e KNJZ-së.
7. Përfaqësuesit e mediave që largohen nga vendvotimi gjatë procesit të numërimit nuk lejohen të kthehen sërish në vendvotim.

## Neni 8

### Vëzhgimi i procesit të numërimit në vendvotim

1. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në Njësinë Zgjedhore mund të vëzhgohen nga vëzhguesit dhe mediat e akredituara.
2. Brenda vendvotimit lejohet prania e jo më shumë se një vëzhguesi nga e njëjta organizatë e akredituar ose kandidat propozues.
3. Vëzhguesit qëndrojnë përballë grupeve të numërimit, në largësi të përshtatshme nga tavolinat e punës dhe nuk lejohen të kenë kontakt fizik me materialet zgjedhore.
4. KNJZ verifikon vëzhguesit dhe lejon qasjen në vendvotim në përputhje me vendimin e KQZ-së.

## Neni 9

### Dispozitat përfundimtare

Të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore rregullohen me vendime të veçanta të KQZ-së.

## Neni 10

### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Prishtinë, 27.02.2026



Kryetare e OIK  
Nexhmije Gori